




REPUBLIKA E KOSOVË / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY			
Dep.	03-02/DPK	Nr Prot	01-1745/16
Dep.		Bi Prot	
Nr. f. llog.		Prot No	
Broj stranica	04	Data	13.05.2016
Nr. pages		Datum	
SHËNË			



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.05.2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-02-3958/15, për z. Slavisa Jakovljevic – Nënkryetar i Komunës së Obiliqit, për shkak se ai ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK – 03-02-3958/15, për z. Slavisa Jakovljevic – Nënkryetar i Komunës së Obiliqit, dhe njëkohësisht bashkëpronar në biznesin privat “Eko-Plemetina”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Jakovljevic në fillim është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës ai është takuar me zyrtarët e AKK-së.

Zyrtari i lartë është njoftuar se nuk mund të ushtroj funksione menaxhuese në biznese private, krahas funksionit publik të zyrtarit të lartë si dhe për ndryshimet që duhet të bëj për të shmangur konfliktin e interesit. Ai ka premtuar se brenda afatit do t'i bëj ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë zyrtari i lartë z. Jakovljevic ka dërguar në Agjenci informatat mbi biznesin privat, të lëshuara nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, me të cilat vërtetohet se ai ka caktuar një person të autorizuar për të udhëhequr biznesin privat, ndërsa vet ka mbetur në cilësinë e pronarit pasiv. Me këtë zyrtari i lartë ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilin ndodhej.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.


Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

U skladu sa članom 11.(stav1.1), članom 5(stav 1, tačka 1.5), članom 18(stav 10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, kao i sa članom 24(stav 11 i 12) Pravilnika o Radu Agencije protiv Korupcije, br.01/2014, Direktor Agencije protiv Korupcije , 13.05.2016 je doneo sledeću:

**O D L U K U**

**I. Zatvara se slučaj broj AKK – 03-02-3958/15 za g. Slavišu Jakovljevića, Potpredsednika Opštine Obilić , zato što je izbegao stanje sukoba interesa u kojem se nalazio.**

II. Slučaj se može obnoviti u svako doba ukoliko se pojavljuju nove okolnosti.

**O b r a z l o ž e n j e**

I. Pokrenuti slučaj pod osnovanom sumnjom za Sukob Interesa u Vršnju Javne Funkcije, br. AKK – 03-02-3958/15 za g. Slavišu Jakovljevića, Potpredsednika Opštine Obilić, i istovremeno suvlasnik u privatnom biznesu “Eko-Plemetina”, je tretiran po proceduri predviđenim po Zakonu br. br.04/L-051, za sprečavanje sukoba interesa u vršenju javne funkcije,

g.Jakovljević je službenim pismom od Agencije protiv Korupcije upoznat o pokretanju procedure razmatranja mogućeg stanja sukoba interesa, nakon čega se on sastao sa službenicima APK.

Visoki zvaničnik je obavešten da ne može obavljati funkcije menadžera u privatnim biznesima uporedo sa funkcijom visokog javnog zvaničnika i za promene koje treba izvršiti da bi izbegao sukob interesa. On je obećao da će u zakonskom roku izvršiti potrebne izmene u biznesu kako bi izbegao sukob interesa u vršenju javne funkcije.

U međuvremenu, g. Jakovljević je dostavio Agenciji informaciju o privatnom biznisu, izdatog od Agencije za Registraciju Biznisa na Kosovu, kojom se potvrđuje da je on odredio jedno ovlašćeno lice da bi upravljao privatnim biznisom, dok je sam ostao u svojstvu pasivnog vlasnika. Ovim je visoki zvaničnik izbegao situaciju sukoba interesa u kojoj se nalazio. Stoga je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja

II. Uskladu sa članom 18 (stav11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može u svako doba obnoviti slučaj ukoliko se pojavljuju nove okolnosti, pa je odlučeno kao u dispozitivu ovog rešenja .

Odluka se dostavlja:

- visokom javnom zvaničniku
- direktoru DSK
- odgovornom službeniku

Direktor Agencije protiv Korupcije:

Hasan Preteni

